



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 25 shkurt 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

P R O C E S V E R B A L
I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Bojan Stojanovič Emrush Xhemajli, Ibrahim Selmanaj, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Melihate Termkollli, Agim Veliu, Gani Geci dhe Zulfë Merxha.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të 30. 01. 2009 dhe të 10. 02. 2009,
3. Shqyrtimi i projektstrategjisë kundër korrupsionit 2009 – 2011,
4. Shqyrtimi i procesit të shpërbërjes së TMK-së,
5. Shqyrtimi i fushëveprimit të Komisionit,
6. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të 30. 01. 2009 dhe të 10. 02. 2009

Procesverbalet e 30. 01. 2009 dhe të 10. 02. 2009 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektstrategjisë kundër korrupsionit 2009 - 2011

Kryetari i Komisionit - Lidhur me këtë pikë tha se sipas vendimit të Kryesisë, Komisioni ynë, së bashku me Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa, janë ngarkuar ta shqyrtojnë projektstrategjinë kundër korrupsionit për vitet 2009 - 2011. Siç e dini, e kemi caktuar referues z. Gani Geci. Në konsultim me z. Geci, jemi pajtuar të rekomandojmë që kjo projektstrategji të miratohet në lexim të parë. Ma merr mendja se të gjithë kemi vërejtje. Personalisht kam shumë vërejtje, që do t'i shqyrtojmë së bashku gjatë leximit të dytë. Kemi kërkuar që ata ta dërgojnë edhe planin antikorrupsion. Tani fjalën e ka z. Gani Geci.

Gani Geci - E kam shqyrtuar projektstrategjinë kundër korrupsionit. Kam bërë disa rekomandime. Jemi marrë vesh që projektstrategjia të miratohet në parim, ndërsa vërejtjet tona t'i paraqesim edhe në seancë. I keni para jush edhe vërejtjet e mia dhe mund t'i lexoni. Besoj se edhe ju keni vërejtje.

Eqrem Kryeziu - Ne deputetët kemi marrë vërejtje edhe nga OJQ-të për këtë projektstrategji. Në to nuk ka asnjë vërejtje të re, që nuk është paraparë qoftë nga anëtarët e këtij komisioni, qoftë në strategjinë si paralajmërim i caktuar i disa fushave.

Melihate Termkoll - Kemi miratuar edhe më herët dokumente të kësaj natyre, gjithashtu e kemi miratuar edhe ligjin, që është mjaft i mirë. Kam frikë se këto dokumente më shumë po i ndihmojnë korrupsionit se sa luftës kundër tij. Kam frikë se me këtë dokument edhe më lehtë mund të fshihet korrupsioni sado i madh të jetë. Pra, nuk është mirë, problemet që nuk mund t'i zgjidhim, t'i mbulojmë me një dokument, sepse ato duhet të zgjidhen.

4. Shqyrtimi i procesit të shpërbërjes së TMK-së

Kryetari i Komisionit – Tha se ky komision, mbikëqyr procesin e shpërbërjes së TMK-së dhe të formimit të FSK-së. Kam njohuri edhe nga ministri i FSK-së, si dhe nga KFOR-i, se problemet e paraqitura tash e një kohë, për të cilat ne kemi nxjerrë edhe rekomandime, se ky proces do të shkojë mirë. Pra, kemi njohuri se të gjithë pjesëtarëve të TMK-së, do t'u jepet mundësia të shkojnë në trajnim në Vushtrri. Ma merr mendja se ky proces do të shkojë mirë. Ju e keni marrë një raport të përgatitur nga stafi në lidhje me procesin e shpërbërjes së TMK-së dhe të formimit të FSK-së, që unë e kam vlerësuar si të nevojshëm për të gjithë ne.

Gani Geci - Komandanti i KFOR-it, mbrëmë deklaroi se do të shqyrtohen vetëm 5% të rasteve. Mendoj se është dashur të merreshim më shumë me këtë çështje, sepse ata janë pjesëtarë të UÇK-së, të cilët kanë punuar shumë vjet në TMK. Këta pjesëtarë as nuk e kanë arritur moshën e pensionimit, as nuk janë pranuar në FSK. Në bazë të asaj që tha komandanti i KFOR-it, nuk besoj se do të shqyrtohen të gjitha rastet.

Emrush Xhemajli - Mendoj se ky proces ka shkuar shumë më mirë se sa kam menduar. Sipas meje defekti i madh ka të bëjë me orientimin e komandës, sepse ata duhet të fokusohen në trajnime dhe në punët e FSK-së. E di se ata po shprehin ndjenja dhembjeje, por kjo nuk shkon kështu. Ata duhet të merren me detyrat për të cilat janë përgjegjës. Realisht çka është synuar, është arritur me sukses. Është e dhimbshme, por e suksesshme.

Agim Veliu - E kemi miratuar ligjin për këtë proces. Ajo që duhet ta dimë, është a ka shkuar ky proces sipas ligjit. Nëse ka shkuar gjithçka sipas ligjit, nuk kemi çka të diskutojmë më shumë. Gjithashtu mendoj se secili duhet t'i marrë këtu përgjegjësitë e veta - edhe ministri edhe komandanti, sepse ka dallime në deklarata. Disa herë thonë se s'ka qenë në kompetencën tonë, herë-herë thonë se do ta bëjmë këtë e atë, kurse pas dy ditësh del se nuk mund të bëjnë asgjë. Ajo që duhet të bëhet, është të shihet a janë bërë gabime gjatë këtij procesi dhe aty ku janë bërë të përmirësohen.

Melihate Termkollli - Komisioni ka biseduar edhe më herët me pjesëtarët e TMK-së se si do të rrjedhë ky proces dhe si do të veprojmë, sepse paraprakisht e kemi ditur se ai nuk është aq i lehtë. Komisioni duke i ditur këto rrethana, ka bërë rekomandime për Qeverinë në lidhje me këtë çështje, por Qeveria e Kosovës nuk ka marrë asnjë veprim për të. Pra, Qeveria do të duhej të ulej dhe të merrej seriozisht me çështjet që janë të rëndësishme, siç është edhe ky proces.

Shkumbin Demaliaj - Komisioni është mirë ta bëjë një raport së bashku me ministrin e FSK-së dhe t'ua bëjë me dije se nuk ka nevojë për deklarime publike. Ata duhet të merren me FSK-në dhe ta harrojnë punën e TMK-së, sepse ky është mekanizëm tjetër. Nëse çdo gjë bëhet publike, çdo gjë do të politizohet. Që në fillim këtë mekanizëm dhe sektorët e sigurisë mund t'i quajmë të dështuar. Edhe pjesëtarët e TMK-së dalin me kërkesa politike, akuzojnë Qeverinë dhe shpeshherë bien në kundërshtim me vetveten. As ata nuk janë të njoftuar se shteti me mekanizmat ndërkombëtarë do të përkujdeset se në cilin resor do ta gjejnë veten.

Ibrahim Selmanaj - Zhvillimet e fundit që kanë ndodhur gjatë procesit të shpërbërjes së TMK-së dhe të formimit të FSK-së, na bindin se nuk duhet të merremi shumë me pasojat. Si Komision duhet të ofrojmë strategji dhe ndihmesë se si duhet të rrjedhin zhvillimet e më tutjeshme, sepse fjala është për një numër të vogël për të cilët duhet të gjendet zgjidhje. FSK-ja edhe ashtu ka mjaft probleme, sepse s'ka buxhet të mjaftueshëm, pra thjeshtë s'ka kushte elementare për të funksionuar me sukses. Duhet të jemi të guximshëm që ta ndihmojmë këtë proces.

Zafir Berisha - Mendoj se ky proces nuk duhet të shikohet nga prizmi humanitar. Për çdo gjë duhet të mbështetemi në Kushtetutë dhe në ligje. Është e vërtetë se janë bërë disa lëshime, por ma merr mendja se me kalimin e kohës do të përmirësohen. Po e marr një shembull konkret: Në TMK ishte një ekip për çminim të minave, i trajnuar edhe jashtë vendit. Tani pjesëtarët e këtij ekipi nuk kanë kaluar në FSK, pra nuk është mirë tani të vijë ndokush pa përvojë, sepse do ta ketë vështirë. Na duhet një ushtri me rregulla të NATO-s. Pikërisht mendoj se nuk duhet të merremi me çështje humane, sepse ato i përkasin një kategorie tjetër.

5. Shqyrtimi i fushëveprimit të Komisionit

Kryetari - Ju njoftoj se, deri më 15 mars 2009, do të miratohet Rregullorja e re e Kuvendit. Komisioni ynë duhet ta bëjë një korrigjim të fushëveprimit të tashëm. Në mbledhjen e kaluar z. Zafir Berisha është caktuar përgjegjës për hartimin e këtij dokumenti. Ai bashkë me stafin e ka përgatitur një draft, të cilin e keni para vetes. Fjalën e ka Zafir Berisha.

Zafir Berisha - I kemi bërë disa ndryshime nga fushëveprimi i tashëm. E falënderoj edhe stafin mbështetës për ndihmën që më ka ofruar. Kam vetëm një sqarim te pika 5), në të cilën është bërë një lëshim që duhet të korrigjohet. Mund të debatohet dhe besoj se ka vend për ndryshime. Ju mund t'i paraqitni vërejtjet tuaja.

Eqrem Kryeziu - E falënderoj z. Zafir për përpjekjet e formulimit të fushëveprimit. Propozoj që në pikën pik 1) të shtohet edhe togfjalëshi: *verifikimi i raporteve*.

Melihate Termkoll - Mendoj se ky fushëveprim duhet të reduktohet. Na kanë mbetur pa u përfshirë edhe disa çështje thelbësore. Pajtohemi edhe me vërejtjet e z. Eqrem. Gjithashtu në pikën 3) të hiqet *sekretari i përhershëm*, sepse sekretarët këtu s'kanë të bëjnë me asgjë, ndërsa në pikën 4) të saktësohet buxheti i sigurisë.

Emrush Xhemajli – Do të kërkoja që fushëveprimtarisë së Komisionit t'i shtohet edhe Agjencia e Kundërkorrupsionit.

Agim Veliu - Kam vërejtje që formulimi në pikat 1 dhe 8 të jetë më i qartë.

7. Të ndryshme

Kryetari – Në këtë do të përmend faktin se komisioneve tashmë iu ka ndarë një fond vjetor prej 10.000 eurosh. Do të shikojmë si janë planifikuar shpenzimet e këtyre mjeteve dhe duhet ta bëjmë një plan buxhetor për to.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatiti:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Rrustem Mustafa

Kryetar i Komisionit

